

TIRANE ME 05.12.2019

*RAPORT I AUDITIMIT TË FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA GJATË FUSHATËS
ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE 2019, TË SUBJEKTIT
ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"*

DREJTUAR : KOMISJONIT QËNDOR TË ZGJEDHJEVE

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", TIRANË

PËRMBAJTJA

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

i. Kuadri Ligjor

- Ligji nr. 8580, më datë 17/02/2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar me ligjin nr. 10374 datë 10/02/2011
- Ligji nr. 90/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, më datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar "Kreu III/1, Nenet 24/1-24/5.
- Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Miratuar me ligjin nr. 1019, datë 29.12.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.08.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, më datë 02.04.2015); Nenet 86-92.
- Ligji 10091 më datë 05/03/2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar".
- Udhëzimi i KQZ-së nr.1, më datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".
- Udhëzimi i KQZ-së nr.2, më datë 01.06.2017, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiarë për monitorimin e fushatës zgjedhore" dhe standarteve ndërkombëtare të kontabilitetit të parashikuara në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
- Udhëzimi i KQZ-së nr.3, më datë 02.06.2017, "Për mënyrën e llogaritjes së kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga Partitë Politike gjatë fushatës zgjedhore.

ii. Standartet e zbatueshme

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, kryesisht SNA 800, IFRS 4400.
- Standarti Kombëtar i Kontabilitetit të Organizatave jofitimprurëse (SKK për OJF-të), si dhe ligji nr. 9228, datë 29/04/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra.

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

i. Kontrata e shërbimit

Misioni për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, u hartua bazuar në kontratën e shërbimit nr. Prot. 5052 më datë 01.06.2019. Objekti i kontratës është kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019, për partitë politike në përputhje me Kodin Zgjedhor, Ligjin nr.8580, të datës 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10091, të datës 05.03.2009 “Për auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar” dhe Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Raporti i auditimit i fondeve të shpenzuara në fushatën zgjedhore 2019 do të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në këtë kontratë si dhe do të përmbushë të gjitha pikat e nënshkruara.

ii. Vendimi i KQZ-së

Gjithashtu, raporti për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, u hartua bazuar në vendimin nr. 740 të datës 31.05.2019 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe audituesve ligjor, të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019”.

iii. Përgjegjësitë respektive të palëve, subjektit zgjedhor “Partia socialiste e Shqipërisë” dhe ekspertës financiare Sherife Hoxha

a. Përgjegjësia e Drejtimit dhe e Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në raportimin e deklarimeve financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të deklaratave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29. 04.2004, “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe për kontrollin e brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e deklarimeve financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Ata, që janë të ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të partisë politike.

Nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” duhet të vihen në dispozicion të audituesit ligjor çdo informacion, dokumentat e disponuara apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas nenit 91, pika 2, të kodit zgjedhor si:

- Raportimet Financiare të fushtës zgjedhore 2019
- Dokumentat bazë kontabël dhe informacion e duhur
- Dokumentacionin justifikues të shpenzimeve si: faturat fiskale, kontrata apo marrëveshje etj.
- Pasqyrat për llogari bankare të fushatës të subjektit zgjedhor dhe të llogarive të tjera që janë kryer shpenzime dhe të ardhura në funksion të fushatës zgjedhore
- Çdo document tjetër që është në funksion të fushatës zgjedhore
- Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet që janë të nevojshme për arritjen e qellimit të auditimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore

b. Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Raporteve dhe Deklarimeve Financiare.

Auditimi duhet të kryhet duke marrë parasysh konstatimet dhe gjetjet e Raportit të Monitorimit. Audituesi duhet të kërkojë dokumentacion mbështetës për zyrat zgjedhore, veprimtaritë dhe aktivitetet e monitoruara zgjedhore. Shpenzimet e raportuara nga subjekti zgjedhor duhen të krahasohen si me konstatimet e auditimit, ashtu edhe me konstatimet e monitorimit.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto deklarata financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që deklaratat financiare nuk kanë pasaktësi materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në deklaratat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në deklaratat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm, si proçedura auditimi të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shqipërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin dhe përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të deklaratave financiare. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse deklarata për raportimet financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve dhe IFRS-ve, do të identifikojë gjithëmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto deklarime dhe raporte financiare.

Audituesi Ligjor duhet të hartojë Raportin e Auditimit në përputhje me ligjin nr.10091, datë 05.03.2009, "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar", ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike", ndryshuar

me ligjin nr.10374 datë 10.02.2011 dhe ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

Ekspertja financiare do të auditojë në mënyrë specifike:

- Raportimet Financiare (formatin tip) të zgjedhjeve sipas modelit të KQZ-së, duke përfshirë të gjitha pasqyrat e deklarimeve të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike", i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;
- Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj para dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.
- Paraqitjen e raportit të monitorimit dhe çështjeve të shqyrtuara në funksion të raportit të auditimit.
- Në përfundim do të paraqesim një raport për KQZ-në.

C.PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia Socialiste e Shqipërisë sipas dokumentacionit të zyrës së rregjistrimit të partive politike, rezulton e regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me urdhër nr. 36/1, datë 15.08.1991, të Ministrisë së Drejtësisë. Emri i plotë i partisë është "**Partia Socialiste e Shqipërisë**" me initiale "**PS**", të cilat përdoren në dokumentat zyrtare të partisë. Kryetar i partisë është z. Edi Rama. Në organet tatimore është regjistruar me NIPT K713290002F.

Partia Socialiste e Shqipërisë është një parti politike, që e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, konkretisht:

- Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017
- Ligji nr. 1019, datë 29/12/2018, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19/07/2012 dhe ligjin nr. 31/2018, datë 02.04.2015 "Kodin Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.8788 datë 07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimpruesë"
- Akte nënligjore

PS, është bashkim vullnetar i shtetasve shqiptarë mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve dhe interesave të përbashkëta politike, të cilat synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.

Sipas regjistrimit të KQZ-së rezultoi se subjekti zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar në KQZ me Nr. Prot 36, në datë 08.04.2019 **me adresë të Selisë qendrore në Sheshin "Austria" Nr 91, Tiranë.**

Kryetar i partisë është Z. Edi Rama, dhe financiere Znj. Dhurata Isufaj. PS shtrin veprimtarinë e saj në të gjitha rrethet e Shqipërisë. Organizimi i saj është në nivel vendor dhe qendror. Partia Socialiste e Shqipërisë ka shpallur kandidatët për kryetarë bashkie në zgjedhjet vendore 2019, në 60 bashkitë e vendit.

ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)

Qëllimi i Krijimit

Qëllimi dhe objektivat e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" janë të përcaktuara në programin dhe Statutin e saj.

Organizimi dhe drejtimi i Partisë Socialiste të Shqipërisë

Organet drejtuese në udhëheqjen qendrore të PS janë:

- Kongresi i Partisë;
- Asambleja Kombëtare;

- Kryesia e Partisë;
- Kryetari i Partisë;

Organet drejtuese në rrethe te cilat janë përcaktuar në statutin e partisë:

- Këshilli i Kordinuar i Partisë në Qark;
- Asambleja Socialiste e Rrethit;
- Kryetari i Partisë së Rrethit;
- Asambleja socialiste e Bashkise
- Kryetari i Partisë i Asamblesë Socialiste të Bashkisë

Burimet financiare te partisë janë:

- Të ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike;
- Ndihamat dhe dhuratat e anëtarësisë dhe të përkrahësve;
- Të ardhurat nga kuotat e anëtarësimin;
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike

D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat e fushatës zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore të 30.06.2019 janë **79,042,333 lekë**. Këto të ardhura janë krijuar:

- Të ardhurat nga fondet publike 40 868 137 lekë
- Të ardhurat nga persona fizike 2,865,691 lekë
- Të ardhurat nga kontributi i kandidatëve 32,331,770 lekë

- Nga burimet e vetë partisë (kuotat) 2, 976,735 lekë

Tabela e shpenzimeve të fushatës për Partinë Socialiste të Shqipërisë.

Nr rend	Emërtimi	Vlera lekë
1	Aktivitetet	12,716,800
2	Materiale promociionale (bluza,kapele,baner)	2,404,610
3	Shpenzime per flamurë	10,507,450
4	Kontribut për tërmetin Floq (Korcë)	7,000,000
5	Qira zyra elektorale	3,904,050
6	Dhurim në natyrë (Shpenzime indirekte)	2,153,761
7	Kafe, pije, ushqim	1,319,076
8	Kancelari + software	531,038
9	Karburant, transport	3,756,953
10	Karrige me qira	720,000
11	Media sociale	1,111,218
12	Tatim në burim	585,608
	Totali	46,710,564

Tabela e shpenzimeve të fushatës të kandidatëve për kryetar bashkie

Nr rend	Emërtimi	Vlera lekë
1	Aktivitetet	10,547,805
2	Materiale promocionale (bluza, kapele, baner)	4,639,929
3	Karburant, transport	250,800
4	Shpenzime administrative	15,668,842
5	Media sociale	897,326
6	Botime	135,000
7	Konsulenca	192,068
	Totali	32,331,770

ii. Takimet dhe komunikimet e audituesit ligjor me subjektin zgjedhor dhe çdo person tjetër të tretë

Bazuar në kontratën e shërbimit nr. prot. 5052 datë 01.06.2019, menjëherë pas përfundimit dhe dorëzimit të Raportit të Monitorimit për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019, ne filluam procedurat e auditimit të fushatës zgjedhore 2019. Përgatitëm dhe dërguam shkresë për fillimin e procedurave të auditimit. Komunikimet tona janë mbajtur me Kryetaren e degës së financës Znj. Dhurata Isufaj dhe financieren e Partisë znj. Zeneida Illica. Komunikimi jonë ka qënë i vazhdueshëm dhe korrekt gjatë gjithë periudhës së auditimit. Informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar nga ana jonë është vënë në dispozicion të stafit tonë sipas planit të auditimit. Puna jonë është përqendruar kryesisht në ambientet e partisë, pasi dhe gjithë dokumentacioni i duhur mbahej në zyrën e financës. Komunikimet kanë qënë dhe nëpërmjet postës elektronike. Në rastet e verifikimeve nga ana jonë për informacione dhe dokumentacione të kandidatëve për kryetarë bashkie, ne, nëpërmjet zyrës së financës së Partisë Socialiste, kemi arritur t'i verifikojmë dhe t'i ballafaqojmë.

iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin e financimit të fushatës zgjedhore të kontrolluar: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit

Përmbledhja e Politikave Kontabël dhe rregullave kryesore kontabël

A. Mënyra e përgatitjes së Raporteve Financiare të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e Qeverisë Vendore të datës 30.06.2019

Ligji nr.8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, datë 22.05.2017, ka përcaktuar që çdo parti politike që është regjistruar në zgjedhje duhet të bëjë publik dhe të dorëzojë pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve raportin për deklarimin financiar të fushatës. Partitë Politike pjesmarrëse në zgjedhje kanë detyrim që 60 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve të dorëzojnë pranë KQZ-së një raport që përmban në mënyrë të saktë të ardhurat e përfituara apo të ardhurat që partia politike ka patur gjendje, të gjitha shpenzimet e kryera në mënyrë të detajuar, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

- Raportet Financiare të fushatës zgjedhore 2019, janë përgatitur sipas formatit tip të miratuara nga KQZ-ja. Kontabiliteti mbahej mbi bazën e parimeve të konstatimit. Fondet e përfituara në të holla, regjistroheshin në momentin e arkëtimit të tyre. Po kështu dhe të ardhurat e përfituara në natyrë në momentin e kryerjes, duke i konvertuar në lekë me kursin e ditës.
- Nga kontrolli i shpenzimeve u konstatua se disa nga shpenzimet nuk janë pasqyruar në momentin e konstatimit të tyre kur janë kryer. Disa faturat tatimore nuk janë lëshuar në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit.
- Faturat tatimore ishin të lëshuara në mënyrë globale pa situacion analitik bashkëngjitur.

B. Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve

Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në bankë. U kontrolluan veprimet e kryera në ditarin e arkës dhe bankës, dhe u konstatuan se veprimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës janë mbajtur sipas rregullave kontabël.

- Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre duke zbatuar rregullat kontabël.
- Monedha e Raportuar: Si monedhë bazë raportimi është përdorur monedha kombëtare, Lekë. Gjendjet janë përgatitur dhe raportuar në Lekë

C. Organizimi i Kontabilitetit.

- Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Partia ka ndërtuar një plan të llogarive vetjake, në përputhje me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshëm kryhet nga dega e financës. Kontabiliteti mbahet në programin ALPHA. Në llogaritë dhe në Raportimet Financiare të Partisë Socialiste, janë evidentuar dhe deklaruar të ardhurat, shpenzimet, faturat ndaj furnitorëve të ndryshëm, për shërbimet e përfituara gjatë fushtës zgjedhore. Në përputhje me misionin e auditimit të fushtës zgjedhore periudha e auditimit mori në konsideratë, ngjarje dhe fakte financiare, që i takojnë fushatës zgjedhore 05.11.2018 deri më 30.09.2019.

Burimet financiare të partisë janë:

- Të ardhura nga buxheti i shtetit, (fondet publike) në përputhje me ligjin për financimin e partive politike.
- Fondet jopublike, të cilat janë dhurimet financiare, dhurimet në natyrë, shpërblimet, kreditë, sponsorizimet apo garancitë e ndryshme nga anëtarët, përkrahësit e Partisë, sipas ligjit për partitë politike.
- Të ardhurat nga burimet e veta të partisë (Kuotat e anëtarësisë)
- Huatë dhe kreditë
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

II KËRKESAT FORMALE

A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po	05.12.2019
	b) dorëzim fizik	Po	05.12.2019
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	05.12.2019

3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës			
	a) Evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Po	15.05.2017
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Po	05.11.2018 -30.09.2019
	c) Identiteti i personit përgjegjës të financës	Po	Dhurata Isufaj

B. ANALIZA

a. Llogaria bankare e veçantë

Llogaria bankare e hapur nga subjekti Zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për fushatën zgjedhore është përdorur kryesisht për qëllimet e fushatës zgjedhore. Por, nga kjo llogari një fond prej 7 000 000 lekë, është dhënë si kontribut për shtëpitë e dëmtuara nga tërmeti në fshatin Floq të Bashkisë Korçë. Siç është konstatuar edhe në raportin e monitorimit ky fond **nuk është në funksion të fushatës zgjedhore**. Pagesa e këtij kontributi është bërë sipas Vendimit të Kryesisë së Partisë Socialiste të Shqipërisë nr. 5, datë 10.06.2019. Transaksioni është kryer më datë 24.06.2019.

Janë hapur tre llogari bankare në Credins Bank në monedhen ne Euro, USD dhe ALL si më poshtë:

- Credins Bank AL94 2121 1016 0000 0000 0092 2832 LEKË
- Credins Bank AL40 2121 1016 0000 0000 0092 2834 USD
- Credins Bank AL13 2121 1016 0000 0000 0092 2835 EUR

Hapja e llogarisë për fushatën zgjedhore është bërë më qëllim për të marrë të gjitha donacionet mbi 100,000 lekë, si dhe për të paguar shpenzimet që lidhen me aktivitetin e fushatës zgjedhore.

Subjekti Zgjedhor PS, nuk ka përdorur asnjë llogari tjetër për të marrë financime publike, vetëm llogaritë e hapura për fushatën zgjedhore në Credins Bank. Disa fatura të shpenzimeve janë paguar edhe në llogarinë bankare në lekë në Bankën Credins me nr. llogarie 00000112879, (jo llogari fushate). Këto shpenzimet janë kryer nga fondet e vetë partisë, para se të hapej llogaria për fushatën zgjedhore dhe para se të lëvroheshin fonde publike.

Subjekti Zgjedhor PS nuk ka llogari bankare “ të fjetura” që janë përdorur për zgjedhjet e mëparshme.

Raporti i financimit të fushatës zgjedhore të PS i raportuar pranë KQZ-së është i balancuar, nuk ka defiçit, totali i të ardhurave është i barabartë me totalin e shpenzimeve.

Nuk janë të balancuara disa raporte të financimeve të kandidatëve për kryetarë bashkie të raportuara nga vetë kandidatët si më poshtë:

Nr rend	Kandidatët për Bashkitë	Te ardhurat e deklaruar	Shpenzimet e deklaruar	Suficit	Deficit
1	Belsh	1,229,750	1,212,000	17,750	
2	Fushë Arrëz	406,502	460,502		(54,000)
3	Gjirokastrë	590,000	491,340	98,660	
4	Libohovë	100,000	70,400	29,600	
5	Cerrik	392,800	330,990	61,810	
6	Mat	1,000,000	456,120	543,880	
	Totali	3,719,052	3,021,352	751,700	(54,000)

Pavarësisht se të ardhurat sipas tabelës së mësipërme janë 3 719 052 lekë, Partia Socialiste e Shqipërisë në deklaratimet e saj ka raportuar të ardhurat e financuara të bararata me shpenzimet e kandidatëve, (3 021 352 lekë). Të ardhurat janë burime të krijuara nga vetë kandidatët dhe donatorët e tyre. Si rrjedhojë subjekti zgjedhor Partia socialiste e Shqipërisë ka ruajtur balancën e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

Llogaritë bankare për fushatën zgjedhore, në Credis Bank (0092 2832 ALL, 0092 2835 EUR dhe 0092 2834 USD), janë çelur sipas evidencës të marrë nga banka më datë 15.05.2017. Këto llogari janë mbyllur pas fushatës zgjedhore, përkatësisht llogaria në lekë 0092 2832 më datë 23.10.2019, llogaria në USD 0092 2834 më 08.10.2019 dhe llogaria në EUR 0092 2835, më datë 08.10.2019.

Ne kemi siguruar bank statement që ka të bëjë me transaksionet financiare në funksion të fushatës zgjedhore, e cila përfshin periudhën nga 05.11.2018 deri më 30.09.2019.

b. Personi përgjegjës për financën

Subjekti zgjedhor i PS ka një staf të punësuar prej 2 punonjësve në pozicionin e financierëve. Nga të punësuarit bëhet rregjistrimi dhe mbahet kontabiliteti në programin ALFA në përputhje me rregullat kontabël dhe legjislacionin fiskal. Personi përgjegjës për financat e Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe degën e thesarit është Kryetarja e Degës së financës znj. Dhurata Isufaj, e cila ka rolin kryesor në drejtimin e degës së financës.

Partia Socialiste e Shqipërisë mban dhe zbaton rregulla të brendshme, në lidhje me dokumentacionin financiar. Nuk ka çështje të mospërputhjeve në deklaratimet financiare të fushatës zgjedhore të datës 30.06.2019.

Raporti i financimit të fushatës zgjedhore është përgatitur dhe është nënshkruar nga Kryetarja e Degës së financës znj. Dhurata Isufaj.

- **Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes**

	a) bosh/mungon informacioni	Jo		
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
		Të Ardhurat		79 042 333
			Financime publike	40 868 137
			Donacione private	2 865 691
			Financim nga burimet e veta të partisë	2 976 735
			Financim nga Kandidatët	32 331 770
			Huatë/Kreditë	
		Shpenzimet		79 042,333
			Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	23 264 605
			Materialet promovuese	17 552 889
			Media	2 008 544
			Sondazhe të Opinionit Publik	0
			Botime	135 000
			Transporti	4 007 753
		Konsulenca	106 220	
		Reklamime në ambiente të hapura	85 848	
		Shpenzimet indirekte	2 153 761	
		Kontribut per termetin	7 000 000	
		Administrative dhe të përgjithshme	22 727 714	

III TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Shuma e pagesës paradhënie	40 868 137	40 868 137
	Data e tranfertës	21.06.2019	21.06.2019
	Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve	0	0
	Data e transfertës	Nuk ka	Nuk ka
	Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka	0	0
	Data e transfertës	Nuk ka	Nuk ka
2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	2 865 691	2 865 961
	Shuma e donacioneve në para	711 930	711 930
	Shuma e donacioneve në natyrë	2 153 761	2 153 761
	Përgatitet një listë e donatorëve		Po (bashkangjitur raportit të auditimit)
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)		po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma)		po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		po
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		Pjesërisht

	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		po
	Respektimi i kufirit të donacionit		po
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	2 976 735	2 976 735
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	0	0
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	0	0
	<i>Botimet</i>	0	0
	<i>Shtypshkronja</i>	0	0
	<i>Marrje me qera</i>	0	0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	2 976 735	2 976 735
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	2 976 735	2 976 735
	<i>Botimet</i>	0	0
	<i>Shtypshkronja</i>	0	0
	<i>Marrje me qera</i>	0	0
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma)		po
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		po
4/ Huatë/Kreditë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	974 400	974 400
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	974 400	974 400
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	06.05.2019;29.05.2021	06.05.2019;29.05.2021
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)		Po (kontrata)
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	po	po

B. ANALIZA

a. Financimi publik

Fondet publike për financimin e fushatës zgjedhore të 30.06.2019 janë transferuar në llogarinë e hapur për fushatën zgjedhore me numër llogarie 0092 2832 ALL (Credins Bank) më datë 21.06.2019, sipas shkresës së KQZ-së nr. 11311, datë 11/06/2019, në shumën 40 868 137 lekë. Pas zgjedheve, Partia Socialiste e Shqipërisë sipas Vendimit të KQZ, nr. 1098, datë 27.07.2019, përfiton një fond shtesë prej 9 098 081 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit ky fond nuk është kaluar në llogaritë e Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Subjekti zgjedhor nuk ka marrë minutazh nga sektori i medias që siguron kohë të lirë transmetimi për fushatën zgjedhore. Sipas Ligjit “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka fituar mbi 20 % të vendeve në zgjedhjet e fundit parlamentare duhet të marrë dy herë më shumë mbulim në edicionet informative se partitë e tjera parlamentare. Subjekti zgjedhor sipas raportimit në deklarin e tij, nuk ka shfrytëzuar kohën në dispozicion falas në transmetimet televizive dhe radiot private kombetare.

Mediat Online, facebook, instagram pothuajse janë të parregulluar me ligj, dhe si të tilla, shpenzimet nuk mund të kontrollohen.

Nuk kemi raste të keqpërdorimit të burimeve publike apo raste të abuzimit të burimeve publike të siguruar nga shteti.

b. Financimi nga burimet jo publike

Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar.

Nga verifikimi i dokumentave, donatorët kanë plotësuar formularin e kërkuar sipas ligjit për konfliktin e interesit. Formularët e plotësuar janë të shoqëruar edhe nga dokumenti i identifikimit të donatorëve. Donatorët kanë zbatuar kufirin e shumës së lejuar, si në nivelin qendror, ashtu

edhe në degët e partisë. Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se nuk ka raste të donacioneve nga burimet jopublike nga i njëjti donator në nivel qendror dhe nga degë e partisë.

Financime nga burimet jo publike të palejuara, nuk ka. Nga inspektimi i dokumentacionit financiar dhe transaksioneve financiare, **nuk identifikua transaksione të pajustificuara që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore.**

Kontributet në natyrë

Gjatë fushatës zgjedhore nuk kemi raste sponsorizimi dhe veprimtari vullnetare. Kontributet në natyrë përfaqësojnë dhurimet në natyrë për zyrat elektorale zgjedhore.

Nga kontrolli i dokumentacionit për kontributete në natyrë rezultoi se nuk ka raste të donacioneve nga i njëjti donator në nivel qendror dhe nga dega e partisë.

Burimet të palejuara për kontribute në natyrë, nuk ka. Nga inspektimi i dokumentacionit financiar dhe transaksioneve financiare, **nuk identifikua transaksione të pajustificuara që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore.**

Kishim raste të përlllogaritura gabim të vlerës së dhurimit në natyrë, ku kontratat ishin vlerësuar me vlerë më të ulët se vlera e përcaktuar sipas çmimeve të referencës, sipas VKM nr. 469, datë 03.05.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave për qëllime tatimore".

[c. Financimi nga burimet e vetë partisë politike](#)

Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë

Kontributet e krijuara nga vetë burimet e partisë janë të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë. Financimet për fushatën zgjedhore nga kuotat janë 2 976 735 lekë. Nuk ka të ardhura nga botimet, shtypshkronjat apo marrje me qira.

- Për zyrat qendrore nuk ka të ardhura të krijuara nga burimet e vetë partisë.

Të ardhurat prej 2 976 735 lekë janë krijuar nga kuotat e anëtarësisë së degëve të partisë në rrethet e vendit. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim të ardhurat për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës së partisë.

- **Degët lokale**

Mat	198,720
Gramsh	203,200
Kuçovë	259,000
Vlorë	134,200
Shkodër	180,260
Pogradec	294,790
Berat	256,600
Prrenjas	229,735
Ura vajgurore	36,000
Durrës	267,900
Mallakastër	183,130
Lezhë	28,000
Gjirokastër	182,400
Krujë	228,000
Sarandë	294,800
Totali	2 976 735

Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement)

Nga nxjerrja e llogarisë të ardhurat e deklaruar sipas raportit të deklarimeve financiare të raportuara nga partia përputhen me shumën e deklaruar në llogaritë bankare. Nga verifikimi i dokumentave financiare hyrjet e të ardhurave në librat e llogarive kontabël u krahasuan me derdhjet në bankë (bank statement) dhe rezultoi se nuk ka diferenca në paraqitjen e tyre.

d. Huatë/Kreditë

Identiteti i huadhënësit/ve

Gjatë verifikimit të dokumentacionit ne identifikuam një rast marrje kredie. Kandidati për bashkinë Maliq ka marrë një kredi për përballimin e shpenzimeve të fushatës. Kredia është marrë nga UNION BANK. Data e lëvrimit të kredisë është 06.05.2019 për shumën 974 400 lekë. Në dokumentacionin e tij na u paraqit edhe kontrata e kredisë. Kontrata e kredisë përmbushte të gjitha detyrimet ligjore.

Data e përfundimit të kësaj kredie është 29.05.2021 me një interes 4.79 %.

Interesat e kredisë nuk janë llogaritur si shpenzim.

IV SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar		46 710 564					
Respektimi i kufirit të shpenzimit		Po					
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në	Faturat paraqitura e	Faturat Përgjithshme e	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e	Shuma përgjithshme e shpenzimeve e

	raportin financimit fushatës zgjedhore e të					paraqitura nga furnitorët	zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	5,375,687	po	po	Situacionet analitike bashkëngjitur faturave tatimore	420 000	ska	5,375,687
Materialet promovuese	10,507,200	po	po	ska	ska	ska	10,507,200
Media	1,026,018	po	po	ska	ska	ska	1,026,018
Sondazhet e opinionit publik	0	ska	ska	ska	ska	ska	0
Botimet	0	ska	ska	ska	ska	ska	0
Transporti	2,242,018	po	po	ska	ska	ska	2,242,018
Konsulenca	0	ska	ska	ska	ska	ska	0
Reklamat në ambientet e jashtme	0	ska	ska	ska	ska	ska	0
Kontribut për tërmetin	7,000,000	Vendimi i kryesisë së PS					7,000,000
Administrative dhe të përgjithshme	1,091,247	po	po	ska	ska	ska	1,091,247
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							

	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin financiarit fushatës zgjedhore	Faturat paraqitura	Faturat Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet paraqitura nga furnitorët	Shuma përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	7,341,113	po	po	Situacionet analitike bashkëngjitur faturave tatimore	ska	ska	7,341,113
Materialet promovuese	2,405,760	po	po	ska	ska	ska	2,405,760
Media	85,200	po	po	ska	ska	ska	85,200
Sondazhet e opinionit publik	0						0
Botimet	0						0
Transporti	1 514 935	po	po	ska	ska	ska	1,514,935
Konsulenca	0						0
Reklamat në ambientet jashtme	0	ska	ska	ska	ska	ska	0
Administrative dhe të përgjithshme	8 121 386	po	po	ska	ska	ska	8 121 386
Shpenzimet zgjedhore							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Pjeserisht Po

B. ANALIZA

a. Respektimi i kufirit të shpenzimeve: 280 milion Lekë → fokusohuni tek “fushatat e shumëfishta” të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

Nga subjekti zgjedhor PS e Shqipërisë, janë kryer shpenzime të fushatës zgjedhore në shumën 46 710 564 lekë. Shpenzimet janë kryer në nivel qendror, nga zyra qendrore e partisë dhe nga degët e partisë në të gjithë vendin. Në lidhje me respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, nuk u identifikuan shkelje të Kodit Zgjedhor, neni 90 pika 3, përse i përket materialeve propagandistike dhe aktiviteteve, **nuk identifikua mosrespektim të kufirit maksimal të shpenzimeve**. Shpenzimet totale nuk e kalojnë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87/3 të këtij kodi.

b. Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

Shpenzimet për degët e partisë janë 19,468,394 lekë. Shpenzimet e aktiviteteve zënë **7 341 113 lekë ose 37.7 %**. Nuk ka një ndarje për shpenzime zbavitje, pagesa për vendin, shpenzimet e paisjeve dhe të dekorit. Faturat e lëshuara në shumicën e rasteve nga furnitorët e organizimit të eventeve janë fatura globale pa situacione analitike.

Tabela e shpenzimeve të fushatës sipas degëve të partisë.

Nr Rendor	Degët e Partisë	Evente	Materiale promocionale	Transport, karburant	Media (Facebook)	Administrative	Dhurime në natyrë	Totali sipas degëve
1	Gramsh			203,200				203,200
2	Kucovë	90,000				169,000		259,000
3	Vlorë	480,000	217,000	232,500		204,700		1,134,200

Raport i auditimit të fondeve të përfitura dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2019, të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë"

4	Mat	10,000	60,000	99,120		29,600		198,720
5	Shkodër	312,000				56,840		368,840
6	Korçë					285,000		285,000
